



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO

Nr. No. Br.

17/12/2024  
01/1292



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/\_\_\_

Datë: 16/12/2024

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në përputhje me nenet 10, 12, 34, 35 dhe 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës së Malishevës, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**PËR THJESHTËZIMIN E SHËRBIMEVE NË KOMUNËN E MALISHEVËS**

- 1.Me këtë vendim synohet thjeshtimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga drejtoritë përkatëse të Komunës së Malishevës.
- 2.Në të gjitha rastet kur qytetari bën kërkesë për një shërbim administrativ, për nxjerrjen e të cilit kërkohet një dokument që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës, zyrtari përkatës i komunës obligohet që dokumentin e tillë të mos e kërkojë nga pala.
- 3.Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si kopje, atëherë zyrtari përkatës kërkon dokumentin për shikim nga pala, dokumenti kopjohet nga ana e zyrtarit dhe vendoset në dosje. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si origjinal, atëherë zyrtari përkatës e nxjerr dhe e vendos në dosje, por nuk e kërkon nga pala.
- 4.Të gjitha shërbimet administrative për nxjerrjen e të cilave kërkohen dokumente mbështetëse që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës janë të paraqitura në Shtojcën I të këtij Vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi dhe zbatohet nga data 01 janar 2025.

Iu dërgohet;

- Zyrës së kryeministrit,
- MAPL-së,
- Të gjitha drejtorive komunale,
- Arkivit të Komunës.

Kryetari i Komunës

Ekreni Krasari



**Shtojca 1: Shërbimet e thjeshtuara të Komunës së Malishevës**

Nr.	EMRI I SHËRBIMIT	EMRI I DOKUMENTAVE QË NUK KËRKOHEN MË PËR MARRJEN E SHËRBIMIT
<b>DREJTORIA PËR EKONOMI DHE FINANCA</b>		
1.	Certifikata mbi gjendjen ekonomike	1. Kopje e letërnjoftimit 2. Kërkesa e plotësuar
2.	Vërtetim për vizë	1. Kopje e letërnjoftimit 2. Kërkesa e plotësuar
<b>DREJTORIA E INSPEKSIONIT</b>		
3.	Pëlqim për plotësimin e kushteve teknike minimale të bizneseve individuale dhe shoqërive tregtare	1. Kopje e letërnjoftimit 2. Kopje e çertifikatës së biznesit
4.	Vërtetimi për mbajtjen e vijave urbane	1. Vendimi nga DShP
<b>DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME</b>		
5.	Kërkesa nga qytetarët për marrje të shërbimeve të ndryshme në kompetencë të komunës	1. Kopje e letërnjoftimit
<b>DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE</b>		
6.	Vazhdimi i vijave urbane të transportit publik	1. Kopje e çertifikatës së biznesit 2. Vendimi nga DShP
7.	Pëlqim për shfrytëzimin e hapësirave publike nga bizneset	1. Kopje e letërnjoftimit 2. Kopje e çertifikatës së biznesit
<b>DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTËR</b>		
8.	Ndërrim i destinimit të tokës nga bujqësore në ndërtimore	1. Vërtetimi i tatimit në pronë
<b>DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE</b>		
9.	Participimi (për fletëpagesë) të librezës së veteranit	1. Kopja e librezës së veteranit (afati i skandencës)

10.	Vërtetim /Konstatim ( SNS) për fitimin e shtetësisë së Kosovës	1. Vërtetimin që personi nuk është nën hetime 2. Kopje e pasaportës
-----	--	--